

THIRRJE PËR APLIKIM:

Dokumentimi i aseteve të trashëgimisë kulturore në fshatin Letnicë

Nga 18 deri më 22 gusht 2025

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) prej kohësh njihet rolin e të rinjve në promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Që nga viti 2018, OSBE-ja ka organizuar kampe rinore për trashëgiminë kulturore për të rinj nga komunitete të ndryshme me qëllim që të fitojnë përvojë praktike në ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Në vitin 2025, fokusi i OSBE-së gjatë kampit të punës për të rinjtë për trashëgiminë kulturore do të jetë **dokumentimi i aseteve të trashëgimisë** që ndodhen në fshatin Letnicë (komuna e Vitisë).

Nga **18 deri më 22 gusht 2025**, OSBE-ja do të organizojë trajnim praktik pesëditor për dokumentimin e aseteve të trashëgimisë për dhjetë (10) studentë universiteti nga komunitete të ndryshme.

Studentët do të mësojnë rreth historisë së Letnicës, mënyrën se si t'i dokumentojnë më mirë pasuritë e trashëgimisë por edhe për standardet ndërkombëtare udhëzuese, siç janë vlera historike, vlera shoqërore, vlerat estetike, vlerat shkencore/arsimore e kështu me radhë.

Kampi i punës do të jetë me interes për të gjithë studentët që janë të interesuar në promovimin dhe/ose ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Gjatë pesë ditëve, studentët do t'i zhvillojnë aftësitë e tyre praktike në fushën e trashëgimisë kulturore përmes dokumentimit praktik të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore në fshat. Përvojë që kombinon mësimin me ndikimin konkret! Studentët mund të jenë nga çdo fakultet përkatës, por mundësia e ofruar mund të jetë me interes të veçantë për studentët e arkitekturës, antropologjisë, trashëgimisë kulturore, shkencave shoqërore ose turizmit. Njohja e gjuhës angleze është e dëshirueshme.

Historiku

Që nga viti 2018, OSBE-ja ka organizuar kampe rinore për trashëgiminë kulturore. Këto kampe u kanë mundësuar të rinjve nga komunitete të ndryshme përfitimin e përvojës së punës praktike në dokumentimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Kosovë nën drejtimin e një eksperti ndërkombëtar. Kampet e mbajtura mundësuan plotësimin e mësim-nxënies akademike me njohuri, aftësi praktike dhe shkëmbimin e ideve mes kolegëve gjegjësisht pjesëmarrësve që vijnë nga formime dhe mjedise të ndryshme, duke nxitur kështu ndërveprim dhe bashkëpunim mes të rinjve nga komunitete të ndryshme, promovim të mirëkuptimit dhe respektit për diversitetin kulturor.



Kur dhe ku do të zhvillohet kampi i punës për trashëgiminë kulturore?

Kampi i punës është planifikuar të zhvillohet në fshatin Letnicë (komuna e Vitisë) nga 18 deri më 22 gusht 2025.

Akomodimi do të sigurohet në Hotelin “Astoria” në Gjiilan.

Shpenzimet e pjesëmarrësve: Misioni i OSBE-së në Kosovë do të mbulojë të gjitha shpenzimet për pjesëmarrësit (transport dhe akomodim me pansion të plotë).

Kush mund të aplikojë?

Studentët e regjistruar në arsim të lartë (përfshirë studentët e nivelit master) me interes të fortë në promovimin dhe/ose ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Studentët aplikues mund të jenë nga çdo fakultet përkatës, por kjo mundësi mund të jetë me interes të veçantë për studentët e arkitekturës, antropologjisë, trashëgimisë kulturore, shkencave shoqërore ose turizmit.

Si të aplikoni?

Studentët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin vijues në cilëndo nga gjuhët zyrtare vendore:

- një Autobiografi (CV,
- një letër e shprehjes së interesit (maksimumi 500 fjalë, madhësia e shkronjave dhe formati ‘Times New Roman 12’),
- një dëshmi e statusit të studentit/es nga fakulteti përkatës që konfirmon statusin e aplikantit si student/e dhe degën e studimit.

Aplikimet duhet të dorëzohen deri më datë 31 korrik 2025, deri në përfundim të orarit të punës.

Aplikimet duhet të dorëzohen me email në adresën: arta.shala-visoka@osce.org, me shënim tek pjesa e temës (ang. 'subject') së emailit: **Dokumentimi i aseteve të trashëgimisë.**

Nëse keni nevojë për ndihmë me aplikimin tuaj, ju lutemi të kontaktoni në numrat e mëposhtëm:

+383 38 240100 ext. 1135

+383 49 950 219

